



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ




<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KABINETI I KRYETARIT
MUNICIPAL PRESIDENT
PREDSIEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002
Info.ferizaj@rks-gov.net

Adresa: „Dëshmorët e Kombit” p.n.

DATA/DATUM/DATE	19. 08. 2026
NR/BR.	01-230
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës
PËRMES/PREKO/RTHROUGH	Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës 
NGA/OD/FROM	Kryetar i Komunës, z. Agim Aliu 
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim-vendim për miratimin e plotësim-ndryshimit e Statutit të Teatrit të Qytetit “ADRIANA ABDULLAHU”

Në bazë të nenit 58, pika 1. h të Ligjit, Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen, nenit 51, pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt, 01 Nr. 50, i datës 28.06.2013, Kryetari i Komunës bën këtë:

PROPOZIM - VENDIM

Propozim - Vendim për miratimin e plotësim-ndryshimit e Statutit të Teatrit të Qytetit “ADRIANA ABDULLAHU”

ARSYETIM

Përmes këtij Propozim-Vendimi kërkohet që të bëhet plotësim-ndryshimi i Statutit të Teatrit të Qytetit “Adriana Abdullahu”, me qëllim të harmonizimit me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-245 për Artin dhe Kulturën, përkatësisht ndryshimin dhe përshtatjen e neneve të statutit ekzistuese në përputhje me kërkesat dhe dispozitat e legjislacionit të ri në fuqi.

Ndryshimet ligjore që kanë ndodhur janë si më poshtë:

Preambula – baza ligjore është ndryshuar.

Statuti i ri mbështetet tash në Ligjin Nr. 08/L-245 për Art dhe Kulturë dhe në Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrat e Publikë, përveç Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të Komunës.

Neni 1 – qëllimi është zgjeruar.

Në të vjetrin përcaktohen statusi, themelimi, organizimi, funksionimi, drejtimi, financimi, planifikimi dhe përfaqësimi. Në të riun shtohen misioni kulturor, funksionimi artistik, menaxhimi administrativ e financiar dhe parimet e përfaqësimit.

Neni 4 – statusi i Teatrit.

Është shtuar formulimi se Teatri “gëzon statusin dhe mbrojtjen si institucion publik i kulturës i Komunës së Ferizajt”. Në historikun e statusit është futur edhe referenca ndaj kodit buxhetor në DKRS.

Neni 5 – ndryshohet adresa.

Në Statutin e vjetër selia ishte Rr. “Dëshmorët e Kombit”, pn. Në të riun përcaktohet Nr. 466.

Neni 6 – ndryshim financiar.

Në vend të formulimit të vjetër se Teatri “përdor xhirollogarinë bankare për qarkullim financiar”, Statuti i ri përcakton se Teatri ka kod të veçantë buxhetor në kuadër të DKRS-së, përmes të cilit realizon qarkullimin dhe menaxhimin financiar.

Neni 7 – ndryshohet përmbajtja e vulës së rrumbullakët.

Në Statutin e vjetër vula kishte tre rrathë me “Republika e Kosovës”, “Komuna e Ferizajt”, emrin e Teatrit dhe logon në mes. Në të riun përcaktohen vetëm llogoja në mes dhe poshtë saj teksti “Teatri ‘Adriana’ – Ferizaj”.

Neni 8 – është zgjeruar veprimtaria.

Shumica e 11 pikave kanë ekuivalent në Statutin e vjetër, por në të riun janë shtuar elemente që nuk kanë qenë të përcaktuara më parë, si: nxitja e mendimit kritik dhe edukimi estetik; hulumtimi i dramaturgjisë kombëtare e botërore; materialet studimore; politikat dhe strategjitë kulturore; platforma mbështetëse për artistët e rinj; bashkëprodhime dhe shkëmbime artistike; digjitalizimi i dokumentacionit teatror; retrospektiva dhe galeri virtuale; simpoziume dhe debate publike pas shfaqjeve; si dhe menaxhimi e mikpritja e festivaleve. Statuti i vjetër i kishte këto veprimtari të formuluara shumë më përgjithësisht.

Neni 9 – eliminohet struktura e vjetër drejtuese.

Statuti i vjetër kishte:

- Këshillin Drejtues;
- Drejtorin e Përgjithshëm;
- Udhëheqësin Artistik.

Statuti i ri ka vetëm:

- Drejtorin e Teatrit;
- Këshillin Artistik.

Këshilli Drejtues dhe Udhëheqësi Artistik hiqen si organe sepse ashtu i parasheh Ligji i ri për Art dhe Kulturë, ndërsa krijohet Këshilli Artistik.

Neni 10 – këshilli Artistik është dispozitë krejtësisht e re.

Ai ka 3 anëtarë, jo 5 si Këshilli Drejtues. Nga një anëtar propozojnë Kryetari i Komunës, Drejtori i Institucionit dhe komuniteti artistik lokal. Mandati është 5 vjet, emërimi bëhet nga Kryetari i Komunës dhe shkarkimi mund të kërkohej nga pala propozuese. Këshilli Artistik nuk është zëvendësim një-për-një i Këshillit Drejtues: roli i tij është këshillues, jo drejtues.

Neni 11 – kompetenca të reja të Këshillit Artistik.

Ky këshill jep konsultime për konceptin artistik dhe tekstet dramatike, këshillon për repertorin dhe programin vjetor dhe jep vlerësime profesionale për projektet skenike e bashkëpunimet artistike. Kompensimi nuk është më fiks 50 euro për mbledhje, por bëhet sipas legjislacionit dhe akteve nënligjore.

Neni 12 – fuqizohet pozita e Drejtorit.

Drejtori përcaktohet shprehimisht si “organi kryesor ekzekutiv i institucionit” dhe drejton jo vetëm administratën, por edhe veprimtarinë artistike dhe kulturore, si dhe administron burimet financiare dhe njerëzore.

Neni 13 – kriteret e reja për Drejtorin.

Kjo dispozitë është ndryshuar thelbësisht. Për herë të parë kërkohej:

- arsim universitar në art dhe kulturë;
- përvojë në institucione kulturore dhe përvojë udhëheqëse/menaxhuese;
- njohuri të përgjithshme të artit dhe kulturës me theks në teatër;
- vizion dhe program të shkruar dhjetëvjeçar për zhvillimin e institucionit.

Statuti i vjetër kërkonte vetëm që drejtori të ishte nga fusha e teatrit ose fusha të përafërta dhe të kishte së paku 3 vjet përvojë. Mandati ishte 4-vjeçar me mundësi rizgjedhjeje edhe një herë.

Neni 14 – ndryshohen sektorët.

Të vjetrit ishin: Sektori i Dramës, Sektori për Fëmijë dhe Sektori i Punëve të Përbashkëta. Të rinjtë janë vetëm:

- Sektori i shfaqjeve për të rritur;
- Sektori i shfaqjeve për të rinj dhe fëmijë.

Shtohet mundësia e skenave eksperimentale, ndërsa organizimi lidhet shprehimisht me Rregulloren për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës.

Neni 15 – burime të reja financimi.

Te të hyrat vetanake tash specifikohen shitja e biletave, librave dhe shërbimeve; te donacionet shtohen grantet; ndërsa si burim i veçantë shtohen rekomandimet e Këshillit Kombëtar/Ministritë përgjegjëse për Kulturë sipas Ligjit 08/L-245.

Neni 16 – auditimi ndahet në nen të veçantë.

Tash përcaktohet shprehimisht auditor i pavarur apo i brendshëm.

Neni 17 – ndryshon kujt i raporton Drejtori.

Në Statutin e vjetër plani dhe raporti i dërgoheshin Këshillit Drejtues për miratim. Në të riun i dërgohen Kryetarit të Komunës dhe Drejtorit të DKRS-së për miratim zyrtar.

Neni 18 – numri minimal i aktorëve dyfishohet.

Statuti i vjetër: minimum 10, maksimum 20 aktorë.

Statuti i ri: të paktën 20 aktorë, pa përcaktuar maksimum.

Po ashtu:

- shkollimi specifikohet si Fakulteti i Arteve – Dega e Aktrimit;
- futet gradimi Profesional 1 deri Profesional 3;
- komisionin nuk e emëron më Këshilli Drejtues, por Komuna/DKRS, nga lista e Drejtorit;
- komisionin e kryeson Drejtori;
- shtohet rregulli se, në konflikt interesi, Komuna cakton kryetar tjetër të komisionit.

Neni 19 – artistët e jashtëm.

Këshilli Artistik tash vetëm konsultohet dhe propozon numrin/profilin e artistëve; përzgjedhjen përfundimtare e bën Drejtori. Në të vjetrin numrin e miratonte Këshilli Drejtues dhe artistët i përzgjidhte Udhëheqësi Artistik.

Neni 20 – rritet numri minimal i premierave nga 3 në 4 në vit.

Statuti i vjetër kërkonte së paku 3 premiera. I ri kërkon 4 premiera. Për më tepër, shtohet shprehimisht e drejta e Teatrit për të realizuar koproduksione me artistë dhe institucione kombëtare e ndërkombëtare.

Neni 21 – zgjerohet pronësia mbi produksionet.

Përveç pronësisë materiale, i ri përcakton se Teatri gëzon të drejtat autoriale mbi produksionet e veta dhe të drejtën ekskluzive të distribuimit, shitjes dhe shfaqjes. Në të vjetrin përmendej vetëm pronësia materiale dhe e drejta e distribuimit.

Neni 22 – ndryshon miratimi për pjesëmarrje në festivale/aktivitete.

Më parë propozonte Udhëheqësi Artistik dhe miratonte Këshilli Drejtues. Tash propozon Drejtori, ndërsa duhet miratim paraprak nga Kryetari i Komunës ose Drejtori i DKRS-së.

Neni 23 – është ndryshuar substancialisht.

Në të vjetrin Drejtori dhe Udhëheqësi Artistik mund të punonin artistikisht jashtë Teatrit vetëm me lejen e Këshillit Drejtues dhe atyre, bashkë me anëtarët e Këshillit, u ndalohej puna krijuese e kontraktuar me vetë Teatrin.

Në të riun krijohet një mekanizëm tjetër: Drejtori dhe punonjësit e Teatrit mund të realizojnë projekte artistike në Teatrin “Adriana” vetëm nëse njëkohësisht:

1. kanë pëlqim paraprak me shkrim nga DKRS ose Kryetari;
2. projekti nuk financohet nga buxheti i Komunës/kodi buxhetor i Teatrit, por ekskluzivisht nga burime të jashtme, donacione ose sponsorizime.

Neni 24 – hapësirat: shtohet shprehimisht dhënia e hapësirave palëve të treta dhe kërkohen kritere për shfrytëzimin e tyre.

Neni 25 – arkiva: në të vjetrin shfaqjet “mund të xhirohen”; në të riun “xhirohen në mënyrë profesionale” dhe kopja ruhet përgjithmonë. Pra, mundësia bëhet detyrim.

Neni 26 – fundusi: shtohet detyrimi që kostumet, skenografia dhe rekuizitat të ruhen në kushte adekuate, si materiale me “vlerë muzeale ose praktike”.

Neni 27 – stafi: përcaktimi i vendeve të punës lidhet konkretisht me Rregulloren e Brendshme për Sistematizimin e Vendeve të Punës, ndërsa masat disiplinore lidhen shprehimisht me Ligjin për Zyrtarët Publikë dhe legjislacionin e punës.

Neni 28 – komunikimi me punonjësit dhe mediat: shtohet posta elektronike zyrtare si mënyrë njoftimi dhe Drejtori përcaktohet si zyrtari i vetëm i autorizuar për deklarata zyrtare në media.

Neni 29 – transparenca: shtohen konferencat për media, përditësimi i faqes zyrtare dhe rrjetet sociale.

Neni 30 – te aktet e brendshme: Në të vjetrin aktet i hartonte Këshilli Drejtues. Në të riun rregulloret dhe aktet e tjera i harton Drejtori i Teatrit.

Neni 31 – shpërbërja: Specifikohet qartë se shpërbërja bëhet vetëm nga themeluesi që është Kuvendi i Komunës së Ferizajt.

Andaj, kërkoj nga Kuvendi si i tillë të miratohet ky Propozim-Vendim.